



Republika e Kosovës - Komuna e Lipjanit  
Shkolla Fillore e Mesme e Ulët  
“Vezir Kolshi”  
Baicë



## HISTORIKU I SHKOLLËS

Rruga e formimit të shkollës sonë ka qenë e gjatë dhe e vështirë, duke pasur parasysh se shkolla është vatrë e diturisë, dëshira e shkollimit në Trevat e Drenicës ishte shumë e madhe dhe e lashtë, por në mungesë të objekteve shkollore, njerëzit e kësaj ane mësimet e para i kanë filluar nëpër shtëpi e oda të fshatit.

Rëndësia e kësaj shkolle ishte e madhe si arsimore, kulturore e historike.

Falë vullnetit të qytetarëve të anës së Drenicës në vitin 1950 ndërtohet shkolla e re në fshatin Baicë me dy dhoma mësimi nga klasa e parë e deri në klasën e katërt, ku mësimet në këtë shkollë i vijonin edhe nxënësit e fshati Resinoc.

Nga klasa e pestë e deri në të tetën nxënësit e këtij fshati mësimet i vijonin në shkollën fillore “Idriz Ajeti” në Shalë, tani “Ibrahim Banushi”.

Në shtatorin e vitit 2010 shkolla jonë pavarësohet nga shkolla e Shalës dhe merr emrin e dëshmorit të kombit “Vezir Kolshi” i rënë në altarin e lirisë.

Vlen të përmendet se nga bankat e kësaj shkolle kanë dalur shumë mësues, profesor, inxhinier, gazetar, doktor e akademik.

Sot, në këtë shkollë mësimi zhvillohet që nga klasa përgatitore e deri në klasën e nëntë se bashku me paralelen e ndarë fizike në Resinoc.

Së fundmi në shkollën e Baicës po zbatohet me sukses Kurikula e re e Kosovës e cila është prioritet ku nxënësit në përgjithësi të nxëni njohuri, shprehje, shkathtësi gjatë gjithë jetës drejtë metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Më datën 25.08.2021

Drejtoreshë: Arianë Bajraktari